



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA HIMARË
KËSHILLI BASHKIAK

Nr.4 prot.

Himarë, më 31.03. 2026

ZBARDHJE E PROTOKOLLIT NGA ORGJINALI I MBLEDHJES TË RADHES SË KËSHILLIT BASHKIAK HIMARË.

Sot më datë 31.03.2026 zhvillohet mbledhja e radhës kërkuar nga Kryetari i Këshillit Bashkiak. Hapet mbledhja në orën 11:00 salla “Neço Muko”.

Të ftuar kryetari Bashkisë, nënkryetarët e Bashkisë, drejtoritë, administratorët e njësjive, kryetarët e fshatrave.

Marrin pjesë këshilltarët :

Dhimitër Kapaj, Elisabeta Lamaj, Aleks Llazari , Mirka Gjiçali, Timoleo Gërdhuqi, Gjergji Iliadhi, Milto Nika, Afrovita Dhimojani, Thëllëza Kokaveshi, Artionil Shirokaj, Maks Vlashi, Qirjako Mërkuri, Artan Bala, Theodhori Foto, Loreta Isufi, Nikolin Laska, Silvana Burbo, Ervis Çaushaj, Nertila Husi.

Plotësohet kuorumi me 19 anëtarë të Këshillit Bashkiak.

Hap mbledhjen kryetari i këshillit.

Fillon rendi i ditës sipas njoftimit.

Para mbledhjes kryesia e KB së bashku me gjithë këshilltarët prezent, diskutuan për problematikat e komisioneve të përhershme për shkak të mosfunksionimit të tyre. Këshilli doli me vendim të plotë për shtimin e numrit të tyre nga 5 anëtarë në 7 anëtarë, 2 prej tyre komisioneve.

Përkatësisht komisioni i ekonomisë shtohet Timoleo Gërdhuqi dhe Artionil Shirokaj, dhe komisioni i bujqësisë shtohet Timoleo Gërdhuqi dhe Nikolin Laska. Komisionet me ndryshimet përkatëse u hodhën në votim dhe u votuan nga të gjithë këshilltarët prezent 19 pro. Kryesia e këshillit bashkiak pasi u konsultua, doli me vendim që komisioni i ekonomisë të shqyrtojë 4 projektvendimet që i takojnë dhe projektvendimi që i takon komisionit të urbanistikës të shqyrtohet në mbledhjen e ardhshme. Komisioni i ekonomisë u mbledh për 40 minuta dhe doli me vendim për 3 projektvendime dhe ti kaloje këshillit për votim.

Fillon mbledhja e këshillit të ditës me përjashtim të projektvendimit nr.17 që do të shqyrtohet mbledhjen e radhës. Plotësohet kuorumi me 19 anëtarë, ora 12:45.

Pika e pare: Miratimi i pagave dhe indeksimi.

Sqaron përsëri drejtorja përkatëse për këtë projektvendim, për pyetjet që bëhen nga këshilltarët. Kalon për votim. 17 pro, 2 abstenim, 0 kundër.

Pika e dytë: Miratimi i buxhetit faktik.

Sqaron përsëri drejtorja përkatëse për këtë projektvendim, për pyetjet që bëhen nga këshilltarët..Merr fjalën dhe kryetari i bashkisë për sqarim mbi buxhetin faktik.Kalon për votim 16pro, 3 kundër , 0 abstenim

Pika e tretë: Miratimi i tavene përgatitore të shpenzimeve periudha 2027-2029 faza 1.

Sqaron drejtorja e financës pyetjet nga këshilltarët.Kalon për votim 16pro, 3 kundër 0 abstenim.

Pika e katërt: Ndihma ekonomike.

Kalon për votim 19 pro 0 kundër 0 abstenim.

Mbyllet mbledhja për muajin mars në sallën “Neço Muko”, ora 13:45.

Sekretari : Zaho Dedi